



PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

BASHKIA KUÇOVË

MESAZH NGA KRYETARI I BASHKISË

Unë besoj te një shprehje, e cila thotë: “Në zemrën e çdo të riu dhe të reje ka potencial për madhësi.” Kjo është arsyeja pse në vazhdimësi kam ndjekur me vëmendje dhe optimizëm përkushtimin e shtuar të pushtetit qendror të Republikës së Shqipërisë ndaj të rinjve në çdo zonë të vendit: duke kulmuar me krijimin e një Ministrie Shteti të posaçme dhe të një ligji dhe strategjie të re për Rininë. Unë besoj se rinia shqiptare mund të udhëheqë me idetë e veta jo vetëm në të ardhmen, por edhe në të tashmen. Ndaj, Plani Lokal i Veprimit për Rininë në Bashkinë Kuçovë - në zbatim të vizionit strategjik qendror - gëzon jo vetëm mbështetjen time, por edhe përkushtimin tim maksimal për realizimin konkret.

Plani, si vijon, është rezultat i një procesi konsultimi, duke përfshirë takime, intervista, seminare dhe një anketë me të rinjtë. Mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve; Aftësimi dhe punësimi rinor; dhe Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore janë tre grupet prioritare të objektivave të këtij plani, i cili u hartua nga Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me shoqatën Ura të Reja në kuadrin e projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Ky dokument politik dhe administrativ i Bashkisë Kuçovë, me mbështetjen e Këshillit të Bashkisë Kuçovë, do të jetë baza, por jo limiti, i vëmendjes së shtuar të pushtetit vendor në Kuçovë ndaj të rinjve, të cilët do të përfshihen në pasurimin dhe zbatimin e vazhdueshëm të tij.

Të rinjtë do të jenë gjithmonë e më shumë përfitues, por edhe hartues dhe udhëheqës të politikave publike në shërbim të tyre. Bashkia Kuçovë përmes këtij plani do të sigurojë mundësitë e nevojshme që të rinjtë të mund të realizojnë aspiratat dhe potencialin që, siç thotë shprehja: gjendet në zemrën e secilit prej tyre.

Kreshnik Hajdari

Kryetar



PËRMBAJTJA

1. Qëllimi, metodologjia dhe kuadri i zhvillimit të Planit	4
2. Bashkia Kuçovë dhe shërbimet për rininë	6
2.1. Zhvillimi social-ekonomik dhe demografia në Bashkinë Kuçovë	6
2.2. Shërbimet dhe infrastruktura për rininë në Bashkinë Kuçovë	7
3. Çfarë do të bëjmë për të rinjtë?	10
3.1. Çfarë duan të rinjtë?	10
3.2. Çfarë mendojnë shërbimet publike për të rinjtë	12
3.3. Vizioni dhe misioni për rininë	13
3.4. Qëllimet, objektivat dhe masat kryesore	14

PRIORITETET TONA:

Mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve



Të sigurohen kushtet e nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Kuçovë.

Aftësimi dhe punësimi rinor



Të rrisim mundësitë e të rinjve për punësim dhe vetë-punësim në Kuçovë.

Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore



Të rrisim pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale.

1. QËLLIMI, METODOLOGJIA DHE KUADRI I ZHVILLIMIT TË PLVR

1.1. Qëllimi dhe objektivat

Plani Vendor i Rinisë është një instrument udhëheqës për Bashkinë në punën e saj me dhe për të rinjtë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve për të rinjtë dhe palët e tjera të interesuara për të plotësuar nevojat e të rinjve të Kuçovës dhe për të krjuar një qytet miqësor kundrejt të rinjve.

Objektivat e Planit Vendor të Rinisë janë:

- ✓ Identifikimi i nevojave të të rinjve të Bashkisë Kuçovë lidhur me shërbimet, mjediset dhe programet.
- ✓ Adresimi i nevojave të të rinjve në fushat prioritare duke vendosur objektiva specifike ambicioze dhe të arritshme si dhe masa konkrete për arritjen e tyre.
- ✓ Identifikimi i mundësive të koordinimit dhe bashkëpunimit me aktorët e tjerë lokalë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë, si dhe pushtetin qendror për adresimin e nevojave të të rinjve.

Ky Plan është realizuar me përfshirje të gjerë të vetë të rinjve si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, të cilët marrin pjesë në realizimin e shërbimeve për rininë. Metodologjia e përdorur për zhvillimin e këtij Planit përfshin rishikimin e dokumenteve, shëyrtrimin e modeleve të suksesshme dhe planet e veprimit të zhvilluar nga bashki dhe aktorë të tjerë, intervista gjysmë të strukturuar, grupe fokus, dhe anketë.

Procesi u lehtësua nga ekspertët e angazhuar nga projekti “Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje, modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjensia Kombëtare e Rinisë dhe zbatuar nga shoqata Ura të Reja.

Faza 1: Shqyrtimi legjislacionit aktual, veçanërsht i Ligjit “Për rininë”, Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe i Strategjise Kombëtare të Rinisë dhe dokumenteve të tjera strategjike që lidhen me rininë. Identifikimi i hapave konkretë nga qeverisja vendore për zbatimin në nivel lokal të legjislacionit dhe politikave kombëtare.

Faza 2: Përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Të rinjtë e përfshirë janë përfaqësuesit e Këshillit Vendor të Rinisë të Bashkisë Kuçovë, të rinjtë e angazhuar në aktivitetet e Qendrës Rinore Kuçovë, shoqatës rinore Ura të Reja që vitet e fundit ka qenë organizata më aktive e shoqërisë civile në Kuçovë, etj. Tre fusha prioritare u identifikuan dhe u vendosën në bazë të strukturës së Planit: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale & mendore e të rinjve; Aftësi dhe punësimi i të rinjve; Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore. Një draft i parë i Planit Lokal të Veprimit për Rininë u zhvillua.

Faza 2: Konsultimi me strukturat e Bashkisë dhe aktorët e tjerë lokalë lidhur me problematikën për rininë dhe zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst, u zhvilluan takime me personat përgjegjës të strukturave përgjegjëse, sidomos stafin e Qendrës Rinore Kuçovë. U identifikua gjendja ekzistuese lidhur me politikat dhe burimet lokale për plotësimin e nevojave të rinisë, mangësitë dhe potencialet. Kontributi i përfaqësuesve lokalë u reflektua në draftin e Planit Vendor të Rinisë.

Faza 4: Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Në këtë fazë, versioni përfundimtar i Planit Vendor të Rinisë i është dorëzuar Kryetarit të Bashkisë Kuçovë dhe Këshillit Bashkiak për aprovim.

1.2. Kuadri i zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë

Plani Vendor i Rinisë është në zbatim të drejtpërdrejtë të Ligji “Për Rininë” (75/2019) dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029.

Ligji “Për Rininë” ngarkon përgjegjësi specifike për njësitë e qeverisjes vendore të cilat, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Një objektivë e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë** është që “të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike” (Objektivi Specifik 1.1).

Në këtë kontekst duhet të forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje

Gjithashtu Strategjia kërkon që «të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale» (Objektivi Specifik 3.2).

Objektivi Specifik 3.3 thekson se «Të rejat dhe të rinjtë të mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)», nëpërmjet ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë.

2. BASHKIA KUÇOVË DHE RINIA

2.1. Zhvillimi social-ekonomik dhe demografia në Bashkinë Kuçovë

Bashkia Kuçovë bën pjesë në Qarkun e Beratit. Ajo ka një sipërfaqe prej 160.22 km² dhe kufizohet me Bashkitë Lushnjë, Dimal, Berat, Cërrik, Gramsh dhe Belsh. Ajo përfshin 4 Njësi Administrative--Qendër Kuçovë, Perondi, Kozarë dhe Lumas. Bashkia ka në përbërjen e saj 1 qytet (Kuçova) dhe 31 fshatra. Sipas Gjendjes Civile (2023), Bashkia Kuçovë ka 55,207 banorë, ndërsa sipas Censit 2023 janë rreth 31,077 banorë, ku 19,878 janë të moshës 15-65 vjec (nga të cilët 10,123 ose rreth 51% janë femra) dhe 3,602 janë të grupmoshës 0-14 vjeç. Më shumë se 80% e banorëve jetojnë në qytetin e Kucovës dhe në Njësinë Administrative Perondi. Emigrimi është një fenomen i përhapur. 40% e të rinjve nga Bashkia Kucovë deklarojnë se duan të emigrojnë.

Bashkia Kucovë është pjesë e Ultësirës Perendimore të Shqipërisë në njësinë kodrinore. Terreni përbëhet nga vargje kodrinore me lartësi të ulët, midis të cilave ka disa lugina ku kalojnë lumi Devoll dhe përrenj të tjerë, dhe shkëmbinj të dobët dhe të paqëndrueshëm. Zona fushore shtrihet përgjatë rrjedhës së lumejve Devoll dhe Osum. Bashkia Kucovë ka një rrjet hidrografik të pasur pasi në territorin e saj kalon lumi Devoll, i cili në kufirin me Bashkinë Dimal, bashkohet me lumin Osum, duke krijuar lumin Seman. Në territorin e Bashkisë ka edhe shumë përrenj dhe rezerva të tjera ujore. Në Bashkinë Kucovë kombinohen burimet të bazuara kryesisht tek nafta me sektorin bujqësor të zonave rurale. Pjesë e resurseve të kësaj bashkie është dhe aerodromi në hyrje të qytetit, aktualisht nën administrimin e NATO-s.

Burimi kryesor i Kuçovës është nafta dhe gazi, që janë zbuluar në mënyrë primitive që në kohën e mbretërisë së Mbretit Zog, plotësuar me zbulime të reja në kohën e pushtimit të Italisë, dhe pasuruar me investime në nxjerrje dhe përpunim gjatë viteve të socializimit.

Nxjerrja e naftës dhe gazit është shkatërruar pjesërisht gjatë tranzicionit në fillim të viteve 1990. Aktualisht zona naftënxjerrëse është nën administrimin e ALBETROL. Ndërmarrja e nxjerrjes së naftës vazhdon punën, ndërsa ajo e përpunimit të naftës jo, pasi nafta bruto dërgohet në Patos për t'u përpunuar. Janë qindra puse naftë në të gjithë territorin e Bashkisë Kucovë, kryesisht në fshatrat Gegë, Havalehas, Frashër dhe në qytetin e Kuçovës. Numri i lartë i puseve të naftës, aktive apo të braktitura, ka lënë pas probleme të rënda lidhur me ndotjen mjedisore. Ndotja e ajrit dhe tokës për shkak të industrisë së naftës dhe të mjeteve të transportit, të cilat ndikojnë në shëndetin e banorëve si edhe në prodhimin bujqësor dhe blektoral.

Në Bashkinë Kuçovë ka 1 shkollë të mesme dhe 11 shkolla 9-vjecare dhe 4 shkolla të bashkuara. Shkollat e mesme kanë akses të mirë dhe kanë kapacitete optimale klasash për zhvillimin e mësimi. Sidoqoftë gjendja fizike e tyre lë për të dëshiruar. Shkollat e mesme të Kozares, Zdravës dhe Salcë Kozarës janë në gjendje të degraduar dhe kanë nevojë për rikonstrukcion tërësor. Asnjë nga objektet arsimore nuk ka laboratorë dhe të gjitha kanë nevojë për pajisje dhe mjete mësimore.

Bashkia Kucovë ka 20 institucione shëndetësore, përfshirë një spital në qytetin e Kucovës, 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultatore, 3 shërbime dentare dhe 9 farmaci.

Qarku i Beratit, ku bën pjesë edhe Bashkia Kucovë, është ndër qarqet me përqindjen më të lartë (12.7%) të varfërisë në rajon (krahasuar me Elbasanin, Korçën, Gjirokastrën). 347 familje përfitojnë ndihmë ekonomike nga buxheti i shtetit dhe 65 familje nga buxheti i bashkisë. Gjendja e strehimit është problematike. 377 familje kanë aplikuar për programet e strehimit, ku shumica janë përfituesit e ndihmës ekonomike (252), familje Rome dhe Egjiptiane (46), kryefamiljare femër (20), persona me aftësi të kufizuara (21), etj.

Situata e punësimit në Bashkinë Kucovë është e ndryshme në nivel njësie administrative. Punësimi është i orientuar drejt sektorit bujqësor për Njësitë Administrative Kozarë, Perondi dhe Lumas. Sektori i shërbimeve dhe tregëtisë në këto njësi zë rreth 10% të të punësuarve. Kurse në Kucovë, sektori kryesor është shërbimet, ku janë 40% e të punësuarve, industria, ku janë 33% e të punësuarve, dhe pastaj tregëtia. Në bashkinë Kucovë, norma e papunësisë është 20.5%.

2.2. Shërbimet dhe infrastruktura për rininë

Bashkia Kuçovë mbështet realizimin e aktiviteteve për rininë si:

- ✓ Aktivitete sportive, çlodhëse dhe argëtuese, të cilat realizohen në kuadrin e Shërbimeve Rekreative dhe Sportive (nënfunksoni 081);
- ✓ Ngjarje kulturore dhe aktivitete për mbrojtjen dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore të cilat realizohen në kuadër të Shërbimeve Kulturore (nënfunksoni 082), me përfshirjen e Bibliotekës Publike dhe Qendrës Rinore. Në Bibliotekë organizohen aktivitete rinore që nxisin kulturën e të lexuarit. Qendra Rinore synon krijimin e një jete sa më të pasur sociale dhe kulturore për të rinjtë.
- ✓ Bashkia Kuçovë është gjithashtu e angazhuar për krijimin e mundësive për punësim dhe sipërmarrje rinore. Janë zhvilluar trajnime 3-4 mujore për të rinjtë e interesuar. Në marrëveshje me Zyrën e Punës, realizohen praktika profesionale për të rinjtë që sapo kanë përfunduar studimet ose janë në vazhdim. Vetëm pranë Bashkisë, në periudhën 2021-2024, kanë kryer praktikën profesionale 13 të rinj. Gjithashtu, çdo vit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, zhvillohet programi i thirrjeve për praktikantë e punës ku të gjithë të rinjtë aplikojnë online për praktika profesionale.

Gjatë periudhës janar – gusht 2024, janë zhvilluar 48 aktivitete. Nëpërmjet konkurseve, janë nxitur, evidentuar dhe vlerësuar të rinj të talentuar në fusha të ndryshme të artit, letërsisë, sportit, etj. Sikurse edhe vitet e tjerë, në 2024U zhvillua gjithashtu dhe kampi veror si çdo vit në Qendrën Rinore me pjesëmarrje të grupmohave të ndryshme. Kampionatet e futbollit, asketbollit, volejbollit dhe ping pongut mes të rinjve zhvillohen nga Zyra Vendore Arsimore dhe nga drejtoritë e shkollave.

Shpenzimet e parashikuara për shërbimet rekreative dhe sportive për vitet 2023-2025 janë rreth 2,424,000 lekë/vit (ose rreth 0.4% të buxhetit total të bashkisë), ku pjesa më e madhe shkon për paga dhe sigurime dhe shpenzime operative. Për Qendrën Kulturore (ku përfshihet edhe Biblioteka dhe Qendra Rinore), për vitet 2024-2025 janë parashikuar rreth 10,809,000 lekë/vit (ose rreth 2% të buxhetit total të bashkisë), ku pjesa kryesore shkon për paga dhe sigurime dhe shpenzime operative dhe vetëm 1.200,000 lekë/vit janë parashikuar për investime. Ndërsa Agjensia e Shërbimeve Komunale ka në buxhetin vjetor 2.000.000 lekë për materiale për mirëmbajtjen e godinave, 500.000 lekë për materiale hidrosanitare, 500.000 lekë për materiale për mirëmbajtjen e sistemit elektrik, 1.200.000 lekë për materiale për mirëmbajtjen e rrethimeve të dëmtuara dhe 1.500.000 lekë për vendosjen e kamerave të sigurisë në shkolla.

Për vitin 2024, buxheti i vënë në dispozicion për aktivitetet sociale, artistike dhe kulturore është 3.263.000 mijë lekë, veçanërisht për zhvillimin e aktiviteteve sociale në Qendrën Rinore, të cilës i janë alokuar 300.000 mijë lekë. Është parashikuar një buxhet për blerje librash dhe raftesh dhe skene. Në kuadrin e shpenzimeve për arsimin, është përfshirë rikonstruksioni i sheshit dhe këndit sportiv në shkollën “Koç Korçari”.

Sidoqoftë, për shkak të burimeve të kufizuara, Bashkia Kuçovë është e varur në një masë të konsiderueshme nga aktorët e tjerë për realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me fuqizimin dhe pjesëmarrjen qytetare, mirëqenien fizike dhe mendore, apo aftësimin dhe punësimin e të rinjve. Të ardhurat nga transfertat e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të bashkisë për realizimin e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara. Ndërsa të ardhurat e veta të programuara për buxhetin e bashkisë për vitin 2025 janë 210,059,000 lekë, ose rreth 38% e shpenzimeve të planifikuara (539,936,000 lekë).

Janë disa strukturat lokale të tjera që janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për rininë.

KËSHILLI VENDOR RINOR

Bashkia Kuçovë ka krijuar Këshillin Vendor Rinor i cili mbledhet çdo muaj. Disa anëtarë të KVR kanë qenë të pranishëm në mbledhjet e Komisioneve të ndryshme të Këshillit Bashkiak, ku kanë diskutuar mbi mundësinë e realizimit të nismave të ndryshme rinore.

QENDRA RINORE KUÇOVË

Bashkia Kuçovë ka ngritur **Qendrën e Kulturës Feniks**, e cila ka në varësinë e vet edhe Qendrën Rinore Kuçovë. "Qendra Rinore" Kuçovë është struktura kryesore e Bashkisë Kuçovë në shërbim të fuqizimit të rinisë.

Qendra Rinore Kuçovë është ngritur në vitin 2002, në kuadër të një projekti të Save the Children. Në vitin 2008, qendra kaloi në pronësi dhe varësi të Bashkisë Kuçovë.

Qendra është e vendosur në një ndërtesë me një sipërfaqe totale prej 240 m². Ajo ka mjediset, pajisjet dhe mjetet nevojshme, që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore--sociale, artistike, kulturore, sportive, si dhe trajnuese, përfshirë edhe aftësimin digjital--të cilat përfshijnë: 3 salla për zhvillimin e aktiviteteve në kushte relativisht të mira; dy piano, 3 kitare, një fizarmonikë, tavolinë pingpongu, tavolinë mini-futbolli\bilardo, 6 kutia shahu, një ludo; 6 lap top, 2 kompjuter dhe një printer; dy kondicionerë dhe një frigorifer. Mjetet dhe pajisjet janë siguruar nga bashkia si dhe në sajë të bashkëpunimit me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, si shoqata "Ura të Reja", organizata "Help", etj. Në ambjentet e jashtme është improvizuar një fushë basketebolli. Në strukturën e Qendrës janë një përgjegjës dhe 2 specialistë.

Angazhimi në qendër u jep mundësi të rinjve që të mësojnë lidhur me angazhimin qytetar, avokimin për çështje rinore dhe lokale, planifikimin, organizimin, drejtimin, prezantimin e projekteve, si dhe të zhvillojnë aftësi të vecanta në art, muzikë dhe sport.

Gjithashtu, në Qendër të rinjtë trajnohen për procedurat vendore mbi sipërmarrjen, aplikimin dhe funksionimin e sipërmarrjes nga të rinjtë.

Të rinjtë janë inkurajuar që të marrin drejtimin e qendrës. Qendra drejtohet nga një Bord Rinor, i përbërë kryesisht nga të rinj të shkollës së mesme, me përvoja të ndryshme, të cilët kanë qenë aktiv në qendër, si dhe të rinj të angazhuar rishtaz me dëshirë dhe ide të reja. Presidenti i Bordit drejton dhe e përfaqëson Bordin Rinor.

Bordi Rinor rinor ka bërë të mundur që të ekzistoj një grup bërthamë të rinjsh që aktivizohen vazhdimisht në qendër. Ky grup drejton aktivitetet në qendër, merr pjesë në to, si dhe shërben si model për bashkëmoshatarët duke ndikuar në rritjen e numrit të të rinjve që frekuentojnë qendrën. Bordi Rinor trajnohet në vazhdimësi për të realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Për aktivitete/ projekte të ndryshme si mbikqyrja e bibliotekës dhe frekuentimi i saj, mbarëvajtja e klasave të kompjuterit, etj., Bordi angazhon ekupe të rinjsh të cilët drejtohen nga anëtarë të Bordit dhe/ose të rinj të caktuar prej tij.

Një nga qëllimet e qendrës rinore është të aftësojnë të rinjtë për të kryer me sukses aktivitetet e tyre duke u informuar dhe duke ndarë me shokët përgjegjësitë. Aktivitetet/projektet rinore realizohen: Me nismën dhe drejtimin e të rinjve, ku të rinjtë zhvillojnë dhe zbatojnë idetë e tyre në art, muzikë apo sport; Me nismën e të rinjve por nën mbikqyrjen e të rriturve, ku të rinjtë, të ndihmuar nga punonjësit e Qendrës Rinore, të cilët i ndihmojnë të zhvillojnë aftësitë e nevojshme dhe të identifikojnë burimet ekzistuese në komunitet si dhe i ndihmojnë për realizimin e ideve të tyre; Me nismën dhe drejtimin e të rriturve, ku anëtarë të komunitetit, të gatshëm për të ndarë me të rinjtë njohuritë, aftësitë apo përvoja të caktuara, prezantojnë idetë e tyre në Bordin Drejtues të Qendrës, me synimin që të rinjtë të fitojnë aftësi dhe eksperiencë për të përsëritur aktivitetet në mënyrë të pavarur në të ardhmen.

Qendra bashkëpunon ngushtë me Këshillin Vendor Rinor të ngritur nga Bashkia Kuçovë. Të rinjtë që frekuentojnë Qendrën Rinore informohen mbi çdo vendim të Këshillit Bashkiak në lidhje me politikat rinore, të inicuar nga anëtarët e KVR-së dhe aktorë të tjerë.

Për realizimin e aktiviteteve në Qendër, Qendra Rinore koordinon dhe bashkëpunon me organizatat dhe projektet jo-fitimprurëse që janë aktive në Bashkinë Kuçovë.

- ✓ Në 2024, Qendra ka bashkëpunuar me shoqatën “Ura të Reja” për realizimin e aktiviteteve të projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, modelon të ardhmen”, financuar nga Agjensia Kombëtare e Rinisë. Gjatë 2022-2023, Qendra dhe “ura të Reja” kanë bashkëpunuar për zbatimin e projektit “Të rinj të fuqizuar, zë aktiv në shkollë dhe komunitet”, financuar nga Kongresi Rinor Kombëtar, në kuadër të TiranaKryeqyteti Evropian i Rinisë 2022, dhe projektit “Aktivizimi rinor dhe dëgjimi i zërit të të rinjve në vendimmarrjen lokale”, financuar nga Lëviz Albania. Këto projekte kanë synuar ndërgjegjësimin e të rinjve për nevojën e angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes në diskutimin e çështjeve lokale dhe vendimmarrjen për to. Të rinjtë kanë zhvilluar aftësitë bazë për të dizenuar dhe realizuar fushata avokimi për çështje rinore dhe për të realizuar inisiativa konkrete rinore.
- ✓ Në sajë të bashkëpunimit me projektin “IDEAL23”, të rinjtë janë fuqizuar për pjesëmarrje në jetën ekonomike-sociale në nivel vendor nëpërmjet ndërgjegjësimin, programeve edukuese dhe inisiativave komunitare dhe avokuese. Ata morën njohuri mbi leadershipin dhe komunikimin krijues përmes lojërave dhe ushtrimeve të ndryshme.
- ✓ Në bashkëpunim me Citizens Channel, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian përmes iniciativës “PËRBALLJE: Përpjekje e shoqërisë civile për të konsoliduar lirinë e medias dhe për të luftuar dezinformimin dhe propagandën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias, është zhvilluar cikli i trajnimeve “Media Literacy – Fake vs Facts” me pjesëmarrjen e 25 të rinjve të Qendrës Rinore. Të rinjtë diskutuan mbi edukimin mediatik, çështjet gjinore në media, aktivizmin përmes medias dhe përdorimin e telefonit për krijimin e materialeve multimediale (Mobile Journalism) dhe realizuan katër produkte multimediale, ku ata raportuan për tematika si emigrimi në qytetin e Kuçovës, pushtet jofunksionale të naftës, problemet e biznesit të vogël si pasojë e rritjes së çmimeve dhe përdorimin e celularit nga të rinjtë.
- ✓ Në Qendrën Rinore Kuçovë dhe në Qendrën Rinore Berat është zbatuar projekti “Berat cycle.act through art” nga organizata “The Youth of Ura” në bashkëpunim me “Mjedisi dhe Komuniteti” dhe “Për ju nëna dhe fëmijë”. Të rinjtë u trajnuan në storytelling, podcasting dhe filmmaking. Projekti u përmbyll me një Hackathon ku u paraqiten produktet e ideuar dhe realizuar nga të rinjtë.

Megjithëse Bashkia Kuçovë nuk ka alokuar në buxhetin e saj burime për mbështetjen e nismave rinore të dizenuara nga organizatat rinore/për të rinjtë apo nga grupet informale rinore, në kuadrin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia ofron staff, infrastrukturën/ ambjentet e saj, dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në inisiativat e realizuara nga aktorët e tjerë.

Në Bashkinë Kuçovë, mbështetja e rinisë realizohet edhe në kuadër të strukturave të tjera të Bashkisë siç janë:

- ✓ **Drejtoria e Shërbimit Social**, e cila ofron shërbimin psiko-social për rastet e konstatuara të problemeve të shëndetit mendor, bullizimit mes fëmijëve e të rinjve, të dhunës në familje, si dhe zhvillon aktivitete me të rinjtë për edukimin e tyre lidhur me përdorimin e alkoolit dhe drogës, ushqimin e shëndetshëm, sigurinë ushqimore, etj. Drejtoria e Shërbimit Social ka një staf prej 6 punonjësish që përfshin Drejtorin, Përgjegjësin e Sektorit të Përkrahjes Sociale, 2 Administratorët e Përkrahjes Sociale, Specialistin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Specialistin për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.
- ✓ **Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Kuçovë**, e cila është përgjegjëse për kushtet higjieno-sanitare, energjinë, ujin dhe telefonin në shkollat. Ajo ofron shërbimet e transportit e nxënësve nga zonat rurale drejt shkollave në zonat urbane. Qendra përfshin specialistin e arsimit dhe sektorin e shkollave të mesme. Ajo ka në varësi të saj Qendrën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara e përbërë nga 2 punonjëse sociale dhe 1 sanitare
- ✓ **Agjensia e Shërbimeve Komunale**, e cila është përgjegjëse për rikonstruktimin dhe mirëmbajtjen e ambjentëve në shkollat 9- vjeçare dhe të mesme.
- ✓ **Spektori Shumësportësh**, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e terreneve sportive.
- ✓ **Spektori i Koordinimit-Zhvillimit dhe Integritit Evropian**, i cili është përgjegjës edhe për projektet, përfshirë edhe ato për rininë.

3. ÇFARË DO TË BËJMË PËR TË RINJTË?

3.1. Çfarë kërkojnë të rinjtë?

Prioritetet dhe ndërhyrjet për organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore

Sipas të rinjve, prioritetet lidhur me organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore janë:

1. Realizimi i programeve/projekteve rinore mbi qeverisjen e mirë dhe pjesëmarrjen/ konsultimin e të rinjve në vendim-marrje.
2. Krijimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë dhe mbështetje për organizimet e nxënësve.
3. Bashkëpunimi midis bashkisë, shkollës, dhe organizatave rinore/për rininë.

Ndërhyrjet konkrete që të rinjtë presin nga bashkia dhe aktorët e tjerë përfshijnë:

- aktivitete të dizenuara sipas nevojave specifike të të rinjve;
- mbështetja e të rinjve për zhvillimin dhe realizimin e iniciativave të tyre, përfshirë edhe këshillimin dhe aftësimin;
- bashkëpunimi midis bashkisë, shkollës dhe organizatave të shoqërisë civile për mundësimin e iniciativave rinore; dhe
- një buxhet specifik për realizimin e iniciativave rinore.



BASHKIA KUÇOVË

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Prioritetet për aftësimin dhe punësimin rinor

Për të rinjtë, prioritetet lidhur me aftësimin dhe punësimin rinor janë:

1. Përgatitja e të rinjve për jetën.
2. Mbështetja për të rinjtë nga shtresat e marginalizuara për aftësim dhe punësim.
3. Bashkëpunimi ndër sektorial për punësimin e të rinjve.

Ndërhyrjet konkrete që presin të rinjtë për jetësimin e këtyre prioritetëve:

- Këshillimi i të rinjve gjatë kalimit në shkollën e mesme dhe të lartë dhe nga shkolla në punë dhe shërbime innovative, miqësore, digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë;
- Informim mbi mundësitë për të rinjtë nëpërmjet takimeve me përfaqësues të aktorëve lokal (Bashki, Zyra e Punës, Qendra e Formimit Profesional, biznese, OJF, projekte, etj.);
- Zhvillimi i aftësive që kërkohen në tregun e punës;
- Lehtësim i transportit publik ndër-qytetas për të mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve nga Njësitë Administrative në kurset profesionale;
- Zhvillimi i aftësive digjitale;
- Aktivitete jashtë-kurrikulare për zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme;
- Ndërmjetësim për punësim;
- Mbështetja e sipërmarrjeve rinore.

Prioritetet për mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve

Të rinjtë mendojnë se prioritetet e Bashkisë lidhur me mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve duhet të jenë:

1. Parandalimi i perfshirjes së të rinjve në krim, trafikim njerezor, dhunë me bazë gjinore, vese sociale;
2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive.
3. Planifikimi dhe realizimi i programeve sociale, artistike, kulturore dhe sportive për të rinjtë, në koordinim dhe bashkëpunim me OSHC-të.
4. Shëndeti fizik dhe mendor i të rinjve.
5. Mbrojtja dhe perfshirja sociale e të rinjve nga grupet e marginalizuara.

Ndërhyrjet konkrete për jetësimin e këtyre prioritetëve:

- Ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë;
- Aktivitete te ndryshme sportive (futboll, basketboll, volejbol, pingpong);
- Eskursione në natyrë;
- Aktivitete sociale, kulturore dhe muzikore;
- Krijimi i hapësirave të sigurta, kundër krimit kibernetik dhe bullizmit online;
- Shërbime/këshillim për për shëndetin mendor dhe psikologjik;
- Takime informuese dhe ndërgjegjëse me punonjësit shëndetësor dhe punonjësit social/psikologët;
- Aktivitete për të rinjtë në zonat rurale/njësitë administrative.

3.2. Çfarë mendojnë shërbimet publike për të rinjtë?

Paraprakisht, është e qartë se të rinjtë dhe stafi i bashkisë ndajnë shumë përsa i përket prioriteteve lidhur me pjesëmarrjen, aftësimin dhe punësimin, dhe mirëqenien fizike dhe mendore të të rinjve si dhe masave konkrete për jetësimin e këtyre prioriteteve.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore

Prioritetet lidhur me *organizimin, fuqizimin dhe pjesëmarrjen rinore* janë:

1. Zhvillimi i politikave rinore bazuar mbi evidenca dhe kontributin e të rinjve
2. Fuqizimi i kapaciteteve të politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë.
3. Bashkëpunimi midis bashkisë, shkollës, dhe OSHC rinore/për rininë për krijimin e një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë dhe mbështetje për organizimet e nxënësve.

Ndërhyrjet konkrete që duhet të bëjë Bashkia janë:

- Krijimi i një baze të dhënash statistikore dhe studimore për rininë;
- Masa konkrete për garantimin e pjesëmarrjes/konsultimit të të rinjve në vendim-marrje;
- Ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe edukimi i votuesve të rinj;
- Mbështetje më të madhe financiare për Qendrën Rinore;
- Programe trajnimi në pjesëmarrjen qytetare për stafin e bashkisë;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me shkollat dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e aktiviteteve të fuqizimit rinor.

Prioritetet për aftësimin dhe punësimin rinor

Sipas punonjësve të bashkisë, prioritetet lidhur me *aftësimin dhe punësimin e të rinjve* janë:

1. Aftësimi i të rinjve për jetën.
2. Lehtësimi i punësimit dhe sipërmarrjes rinore.
3. Mbështetja për të rinjtë nga shtresat e marginalizuara për aftësim dhe punësim.

Lidhur me ndërhyrjet konkrete nga Bashkia për aftësimin dhe punësimin rinor, ata sugjerojnë:

- Takime informuese me të rinjtë për tranzicionin nga shkolla në jetë;
- Keshillim karriere--këshillimi i të rinjve gjatë kalimit në shkollën e mesme dhe të lartë dhe nga shkolla në punë dhe ofrimi i shërbimeve innovative, miqësore dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë;
- Trajnim i stafit mbi këshillimin e karrierës;
- Kurse profesionale;
- Lehtësim i transportit për pjesëmarrjen e të rinjve në kurset profesionale;
- Ndërmjetësim për punësim;
- Mbështetja e startup-eve të të rinjve;
- Aktivitete jashtë-kurrikulare për zhvillimin e aftësive të nxënësve;
- Koordinim dhe bashkëpunim me Zyrën e Punësimit dhe specialistët e tregut të punës, aftësimin profesional, dhe OSHC-ve për rininë.

Prioritetet për mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve

Prioritetet:

1. Parandalim i përfshirjes së të rinjve në krim, trafikim njerezor, dhunë me bazë gjinore.
2. Krijimi i kushteve që të rinjtë të rrinë/kthehen në Kuçovë.
3. Ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike për të rinjtë.
4. Mbrojtja dhe përfshirja sociale e të rinjve nga grupet e marginalizuara.

Ndërhyrjet konkrete nga Bashkia:

- Adoptimi dhe zbatimi i politikave dhe planeve të veprimit specifike për të rinjtë;
- Ndërtimi i më shumë hapësirave për të rinjtë;
- Aktivitete të ndryshme sportive dhe argëtuese (futboll, basketboll, volejbol, eskursione, kampe verore);
- Aktivitete për grupet e marginalizuara;
- Krijimi i hapësirave të sigurta, kundër krimit kibernetik dhe bullizmit online;
- Shërbime për shëndetin mendor dhe psikologjik;
- Takime për të rinjtë me shërbimin social;
- Bashkëpunimi midis bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile për rininë.

3.3. Vizioni dhe Misioni për rininë

Vizioni i Bashkisë për të rinjtë

“Të rinjtë, pjesa më vitale në Bashkinë Kuçovë, si në politikën dhe vendim-marrjen lokale ashtu edhe në veprimtarinë social-ekonomike”.

Misioni i Bashkisë për të rinjtë

“Përmirësimi i gjendjes sociale, fizike dhe mendore dhe fuqizimi i të rinjve për të punuar dhe jetuar në Kucovë dhe për të marrë pjesë aktive në vendimmarrjen lokale.”

3.4 PRIORITETET, QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE MASAT KRYESORE

PRIORITETI 1:

MIRËQENIA AKTIVE, E SHËNDETSHME, FIZIKE, SOCIALE & MENDORE E TË RINJVE

Qëllimi:

Të sigurohen kushtet e nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Kucovë.

Objektiva Specifike 1.1:

Të përmirësohen kuadri ligjor dhe strategjik për sigurimin e kushteve të nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Kucovë.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
1.1.1. Krijimi i një kalendarit që reflekton tërësinë e aktiviteteve, eventeve dhe programeve që ofrohen për rininë në Bashki. Në kalendar përfshihen datat e rëndësishme historike, kulturore, sportive dhe temat sociale që ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqënien dhe formimin e të rinjve. Temat sociale kanë numrin më të lartë të aktiviteteve të programuar dhe zhvillohen çdo javë.	Kalendari i miratuar; Numri i aktiviteteve për rininë; Buxheti i alokuar për realizimin e aktiviteteve.	Qendra Kulturore Qendra Rinore, në nashkëpunim me institucione të ndryshme.	Hartimi i kalendarit: nëntor-dhjetor. Gjatë vitit, kalendar plotësohet me tema të ndryshme të sugjeruara nga vetë të rinjtë.
1.1.2. Përfshirja në buxhet e zerave specifike për aktivitete për rininë.			
Objektiva Specifike 1.2: Të përmirësohet infrastruktura fizike për zhvillimin e aktiviteteve sociale, artistike, kulturore, dhe sportive për të rinjtë e Kucovës.			
1.2.1. Vlerësimi i mjediseve ekzistuese dhe pajisjeve, mjeteve në dispozicion për aktivitete.	Raporti i Vlerësimit; Ambjentet e përmirësuara në Qendrën Rinore;	Qendra Kulturore Qendra Rinore,	Përgjatë gjithë vitit
1.2.2. Krijimi i mjediseve të reja në Njësitë Administrative të Bashkisë.	Pajisjet e shtuara në Qendrën Rinore;	Agjensia e Shërbimeve Komunale	Përgjatë gjithë vitit
1.2.3. Përmirësimi i Qendrës Rinore duke krijuar kushtet e nevojshme për realizimin e kalendarit të aktiviteteve sociale, kulturore, artistike dhe sportive për të rinjtë, brenda dhe jashtë Qendrës.	Ambjentet e brendshme dhe të jashtme për aktivitete sociale, artistike, kulturore dhe sportive në qytetin e Kucovës dhe Njësitë Administrative; Buxheti i investuar për rikonstruktimin e palestrave dhe bibliotekave ekzistuese, si dhe hapjen e bibliotekave /palestrave të reja në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; Numri i bibliotekave dhe palestrave të rikonstruktura.		Përgjatë gjithë vitit
1.2.4. Vlerësimi i gjendjes së shkollave 9-vjeçare dhe të mesme lidhur me infrastrukturën shkollore		Qendra Ekonomike e Arsimit, Agjensia e Shërbimeve Komunale	Përgjatë gjithë vitit
1.2.5. Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale për adresimin e nevojave të shkollave për infrastrukturë të përshtatshme.			Përgjatë gjithë vitit
1.2.6. Rikonstruksioni i shkollave, përfshirë edhe mjediset për aktivitete kulturore, arsimore, sportive dhe sociale brenda dhe jashtë.			Përgjatë gjithë vitit
1.2.7. Krijimi i mjediseve multifunkionale (biblioteka, palestra, terrene sportive) dhe mirëmbajtja e tyre.			Përgjatë gjithë vitit

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Objektiva Specifike 1.3:

Të rritet numri dhe cilësia e aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive për të rinjtë e bashkisë Kucovë.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
1.3.1. Krijimi i Klubeve Rinore: Klubi i Teatrit; Klubi Social; Klubi i Multimedias; Klubi i Sporteve; Klubi i Mjedisit.	Buxheti i venë në dispozicion për të gjitha aktivitetet sociale, artistike, kulturore dhe sportive; Numri i aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive (konkurseve kulturore, festivaleve, shfaqjeve teatrale, ndeshje futbolli, basketbolli, volejbolli dhe ping pongu); Numri i aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive në Njësitë Administrative; Numri i aktiviteteve mjedisore; Numri i aktiviteteve promovuese për të rinjtë e talentuar; Numri i kampeve verore; Numri i të rinjve nga grupet e marginalizuara pjesëmarrës në aktivitetet rinore; Vendimi i Këshillit Bashkiak për transportin urban; Numri i aktiviteteve shkëmbyese.	Qendra Kulturore Qendra Rinore, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Zyra Vendore Arsimore, Qendra Ekonomike e Arsimit	Përgjatë gjithë vitit
1.3.2. Promovimi i të rinjve në fushën e artit: Organizimi i konkurseve të ndryshme kulturore mes shkollave mbi çdo lloj fushe të artit (art skenik, pamor, muzikë, sport).			Përgjatë gjithë vitit
1.3.3. Shfaqje teatrale			Përgjatë gjithë vitit
1.3.4. Kampe verore për të rinjtë e shkollave 9-vjecare dhe të mesme.			Përgjatë gjithë vitit
1.3.5. Kampionate futbolli, basketbolli, volejbolli dhe ping pongu mes të rinjve të shkollave.			Përgjatë gjithë vitit
1.3.6. Aktivitete mjedisore (për pastrimin e zonave të ndryshme të qytetit/bashkisë, mbjellje pemësh, me rastin e ditëve të shënuara si dita e tokës, etj.).			Përgjatë gjithë vitit
1.3.7. Mbështetje për të rinjtë me kushte të vështira ekonomike dhe sociale.			Përgjatë gjithë vitit
1.3.8. Aktivitete specifike për të rinjtë nga zonat rurale/ Njësitë Administrative.			Përgjatë gjithë vitit
1.3.9. Transporti publik për të rinjtë nga zonat rurale për pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara në qytetin e Kucovës.			Përgjatë gjithë vitit
1.3.10. Ndarje eksperiencash me të rinjtë nga Bashkitë e tjera (Berat, Dimal, Tiranë, etj.).		Qendra Kulturore Qendra Rinore, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Zyra Vendore Arsimore, Qendra Ekonomike e Arsimit	Përgjatë gjithë vitit
1.3.11. Bashkëpunimi me institucionet arsimore për realizimin e aktiviteteve për të rinjtë dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në këto aktivitete.			Përgjatë gjithë vitit

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Objektiva Specifike 1.4:

Të përmirësohen shërbimet që mundësojnë një jetesë të shëndetshme të të rinjve.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
1.4.1. Aktivitete që edukojnë fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre për çështje të tilla si përdorimi i alkoolit dhe drogave, ushqimi i shëndetshëm dhe siguria ushqimore.	Numri i sesioneve të këshillimit psiko-social për të rinjtë; Infrastruktura dhe sinjalistika rrugore: polici i shtrirë; kangjellat; sinjalistika vertikale dhe horizontale në të gjitha shkollat, të cilat hyrjen e kanë buzë rrugës.	Qendra Kulturore Qendra Rinore, Qendra Kulturore e Fëmijëve	Përgjatë gjithë vitit
1.4.2. Aktivitete për promovimin e ecjes, ngarjes së bicikletave dhe aktiviteteve sportive për të përmirësuar shëndetin fizik.			Përgjatë gjithë vitit
1.4.3. Aktivitete me shkollat dhe grupet rinore për të promovuar përdorimin e sigurt të teknologjisë për të rinjtë dhe prindërit.			Përgjatë gjithë vitit
1.4.4. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse mbi shëndetin mendor dhe mirëqënien emocionale.			Përgjatë gjithë vitit
1.4.5. Aktivitete/fushata ndërgjegjëse për tematikat sociale dhe shëndetësore që prekin të rinjtë. Takime informuese dhe ndërgjegjëse në qendrat shëndetësore.		Qendra Kulturore; Qendra Rinore; Qendrat Shëndetësore; Drejtoria e Shëndetit Publik	Përgjatë gjithë vitit
1.4.6. Shërbime psiko-sociale për të rinjtë e Bashkisë, referuar nevojave të tyre.			Përgjatë gjithë vitit
1.4.7. Sigurimi i aksesit për nxënësit më aftësi të kufizuar.		Zyra Vendore Arsimore, Qendra Ekonomike e Arsimit	Përgjatë gjithë vitit
1.4.8. Siguria e institucioneve arsimore në Bashkinë Kucovë: Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme mbrojtëse për shkollat të cilat hyrjen e kanë buzë rrugës (polici i shtrirë; kangjella; sinjalistika vertikale dhe horizontale).		Agjensia e Shërbimit Komunal	Përgjatë gjithë vitit

Objektiva Specifike 1.5:

Te rrisim koordinimin dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për realizimin e projekteve dhe programeve sociale, artistike, kulturore dhe sportive.

1.5.1. Shkrimi i projekt propozimeve të përbashkëta me shoqatat e shoqërisë civile që janë aktive në Bashkinë Kucovë.	Numri i projekteve të përbashkëta të zhvilluara dhe zbatuara; Numri i projekteve rinore të OSHC-ve; Numri i OSHC-ve me të cilat bashkëpunon Bashkia/Qendra Rinore.	Qendra Kulturore Qendra Rinore, Specialisti i Projekteve, OSHC-të	Përgjatë gjithë vitit
1.5.2. Mbështetja e nismave të organizatave të shoqërisë civile për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve rinore.			Përgjatë gjithë vitit

PRIORITETI 2: AFTËSIMI DHE PUNËSIMI I TË RINJVE.

Qëllimi: Të rrisim mundësitë e të rinjve të Kucovës për punësim dhe vetë-punësim në vendin e tyre.			
Objektiva Specifike 2.1: Të përmirësohet situata lidhur me aftësimin profesional të të rinjve të Kucovës, me theks në të rinjtë nga grupet e marginalizuara dhe nga zonat rurale.			
Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
2.1.1. Identifikimi i të rinjve që braktisin shkollën herët dhe ofrimi i mundësive që të ndjekin kurse profesionale.	Numri i trajnimeve të zhvilluara për aftësimin e të rinjve në tregun e punës; Numri i të rinjve të trajnuar.	Zyra Vendore Arsimore, Zyra e punës, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore	Përgjatë gjithë vitit
2.1.2. Zhvillimi i trajnimeve të ndryshme për aftësimin e të rinjve në tregun e punës.			Përgjatë gjithë vitit
2.1.3. Trajnime për të rinjtë mbi aftësitë në tregun e punës; sipërmarrja; edukimi për karrierën.			Përgjatë gjithë vitit
2.1.4. Trajnime në TIK.			Përgjatë gjithë vitit
2.1.5. Zhvillimi i praktikave profesionale pranë institucioneve të ndryshme lokale (bashki, OJF, biznese, etj.).			Përgjatë gjithë vitit
Objektiva Specifike 2.2: Të rritet punësimi i të rinjve në sektorët publik dhe jo-publik në Bashkinë Kucovë.			
2.2.1. Krijimi i një portali për punësimin e të rinjve.	Një Portal funksional për punësimin e të rinjve në Bashkinë Kucovë; Lehtësirat administrative të ofruara prej bashkisë për bizneset/ institucionet që punësojnë të rinj; Numri i subjekteve me marrdhenie të formalizuara; Numri i të rinjve të punësuar.	Zyra e punës, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore	2025
2.2.2. Realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Bashkisë, bizneseve dhe institucioneve të ndryshme për punësimin e të rinjve që kanë mbaruar kurset profesionale dhe të tjerë.			Përgjatë gjithë vitit

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Objektiva Specifike 2.3: Të promovojmë sipërmarrjen rinore në Bashkinë Kucovë.			
Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
2.3.1. Ofrimi i trainimeve dhe kurseve të trajnimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, zhvillimin e biznesit, procedurat qendrore dhe vendore, etj.	Numri i trajnimeve të zhvilluara për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, mundësitë e biznesit, procedurat vendore etj; Numri i të rinjve të trajnuar; Numri i sipermarrjeve rinore të mbështetura.	Zyra Vendore Arsimore, Zyra e Punës, Qendra Rinore	Përgjatë gjithë vitit
2.3.2. Mbështetja nga buxheti i Bashkisë i inisiativave sipërmarrëse të të rinjve.			2026
2.3.3. Bashkëpunimi me organizata/projekte jo-ftimprurëse që fokusohen në punësimin rinor për mbështetjen e inisiativave sipërmarrëse të të rinjve.			Përgjatë gjithë vitit
Objektiva Specifike 2.4: Të përmirësohen kushtet për një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës si dhe të rritet orientimi i kurrikulës shkollore drejt tregut të punës dhe të lehtësohet procesi i tranzicionit nga shkolla në punë.			
2.4.1. Pajisja e shkollave 9-vjecare dhe të mesme me laboratorët e nevojshëm për lidhjen e teorisë me praktikën.	Numri i laboratorëve funksionalë në shkollat; 9-vjeçare dhe të mesme.	Zyra Vendore Arsimore, Qendra Ekonomike e Arsimit	Përgjatë gjithë vitit
2.4.2. Seminare informuese me të rinjtë mbi tranzicionin nga shkolla në punë.			Përgjatë gjithë vitit
2.4.3. Sesione për këshillim karriere për të rinjtë.			Përgjatë gjithë vitit
Objektiva Specifike 2.5: Të përmirësojmë koordinimin dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për aftësimin dhe punësimin rinor.			
1.3.1. Shkrimi i projekt propozimeve të përbashkëta me shoqatat e shoqërisë civile që janë aktive në Bashkinë Kucovë.	Numri i projekteve të përbashkëta të zhvilluara dhe zbatuara; Numri i projekteve rinore të OSHC-ve; Numri i OSHC-ve me të cilat bashkëpunon Bashkia/Qendra Rinore.	Qendra Rinore	Përgjatë gjithë vitit, sipas afateve kohore të projekteve
1.3.2. Mbështetja e nismave të organizatave të shoqërisë civile për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për aftësimin dhe punësimin rinor.			

PRIORITETI 3: FUQIZIMI DHE ORGANIZIMI RINOR DHE RITJA E PJESEMARRJES RINORE.

Qëllimi:

Të rrisim pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale.

Objektiva Specifike 3.1:

Të përmirësojmë politikat lokale and aksionin lokal për pjesëmarrjen rinore në politikë-bërjen vendore.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
1.1.1. Alokimi i një buxheti specifik për aktivitetet rinore.	Numri i takimeve konsultuese për buxhetin; Buxhet specifik dedikuar të rinjve; Njoftimet e Bordit për nismat e planifikuara; Numri i iniciativave dhe bashkëpunimeve mes Bordit Rinor dhe Këshillit Bashkiak; Numri i politikave rinore dhe vendimet e konsultuara me të rinjtë, organizatat dhe grupet e tjera politike rinore dhe vendim për të rinjtë, me çdo organizatë apo të ri të interesuar në Bashki.	KVR; Qendra Kulturore; Qendra Rinore; Këshilli Bashkiak	2026
1.1.2. Mirëfunksionimi dhe efektiviteti KVR pranë Bashkisë Kuçovë në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të rinisë së qytetit.			Përgjatë gjithë vitit
1.1.3. Informimi i të rinjve mbi çdo nismë dhe hap që ndërmerr KVR Këshillimor.			Përgjatë gjithë vitit
1.1.4. Ngritje urash bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë, Këshillit Bashkiak, KVR dhe të rinjve të qytetit.			Përgjatë gjithë vitit
1.1.5. Politikat rinore të jenë të hartuara dhe konsultuara në bashkëpunim me të rinjtë, si dhe pjesëmarrja ose dijenia e të rinjve për komisione të posaçme që kanë të bëjnë me ta, pranë Këshillit Bashkiak.			Përgjatë gjithë vitit
1.1.6. Programe motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje dhe qeverisje.			Përgjatë gjithë vitit
1.1.7. Nxitja e aktiviteteve dhe programeve që të rinjtë të informohen më tepër për mundësitë e ndjekjes së mbledhjeve të komisioneve përkatëse në Këshillin Bashkiak			Përgjatë gjithë vitit

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Objektiva Specifike 3.2:

Të rrisim kapacitetin e të rinjve për pjesëmarrje dhe angazhim qytetar.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
3.2.1. Programe dhe fushata ndërgjegjësimi për informimin e të rinjve mbi funksionimin e Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Komisioneve pranë këtij të fundit	Numri i programeve dhe fushatave ndërgjegjëse për informimin e të rinjve mbi funksionimin e Bashkisë, Këshillit Bashkiak; Numri i programeve motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje dhe qeverisje.	KVR; Qendra Kulturore; Qendra Rinore; Këshilli Bashkiak	Përgjatë gjithë vitit
3.2.2. Trajnime për rritjen e kapaciteteve të të rinjve që janë pjesë e KRV (qeverisja me pjesëmarrje, detyrat e këshillit bashkiak, etj)			Përgjatë gjithë vitit
3.2.3. Organizimi i forumeve të përbashkëta me të rinjë në nivel lokal, qarku dhe kombëtar.			Përgjatë gjithë vitit
3.2.4. Fushata ndërgjegjësimi me të rinjtë dhe komunitetin mbi rëndësinë e vullnetarizmit			Përgjatë gjithë vitit
3.2.5. Ëorkshop me të rinjtë për prezantimin e praktikave të mira të vullnetarizimit			Përgjatë gjithë vitit

Objektiva Specifike 3.3:

Të rrisim kapacitetin e stafit të bashkisë lidhur me pjesëmarrjen dhe angazhimin rinor.

3.3.1. Trajnime për stafin e Këshillit Bashkiak për të mbështetur pjesëmarrjen kuptimplote të të rinjve përmes ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve për angazhimin e të rinjve në komunitet.	Numri i aktiviteteve trajnuese; Numri i anëtarëve të KB që marrin pjesë; Numri i tryezave të rrumbullakëta mbi pjesëmarrjen qytetare, me theks rininë, në vendosjen e prioriteteve locale dhe vendim-marrjen për adresimin e nevojave lokale.	KVR; Qendra Kulturore; Qendra Rinore; Këshilli Bashkiak	Përgjatë gjithë vitit
3.3.2. Tryeza të rrumbullakëta mbi pjesëmarrjen qytetare, me theks rininë, në vendosjen e prioriteteve locale dhe vendim-marrjen për adresimin e nevojave lokale.			Përgjatë gjithë vitit

Objektiva Specifike 3.4:

Të përmirësojmë koordinimin dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për fuqizimin e të rinjve.

Masat kryesore	Treguesit	Përgjegjësia	Afatet kohore
3.4.1. Alokimi dhe pasja e një buxheti nga Bashkia Kuçovë, për të adresuar dhe përmbushur nevojat dhe kërkesat e të rinjve të qytetit.	Numri i programeve motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje dhe qeverisje; Numri i organizatave të përfshira në hartimin e buxhetit.	KVR; Qendra Kulturore; Qendra Rinore; OSHC-të aktive në Kuçovë (Ura të Reja, etj.)	2026
3.4.2. Bashkia konsultohet për hartimin e Buxhetit të Rinisë me të gjitha organizatat rinore dhe të rinjtë në Bashki para se të dërgohet për miratim			Përgjatë gjithë vitit



PËR MË SHUMË INFORMACION

Agjencia Kombëtare e Rinisë

✉ info@rinia.gov.al

Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

✉ rinia@kryeministria.al

New Bridges

✉ uratereja@gmail.com

Bashkia Kuçovë

✉ bashkiakucove@yahoo.com

Ky botim u realizua me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, (AKR) dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, (MSHRF). Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR-së dhe MSHRF-së.